



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No
<u>AKK</u>	<u>01-2271/16</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Date Datum Date
<u>02</u>	<u>13.07.2016</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.07.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4625/15, për z. Ajvaz Berisha – Shef i Konsullatës në Frankfurt, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4625/15, për z. Ajvaz Berisha – Shef i Konsullatës në Frankfurt, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “VIP”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht z. Berisha është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së dhe është njoftuar me faktet që posedon Agjencia në lidhje me këtë situatë. Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit nuk ka marr informatë për shmangien e kësaj gjendje, konform ligjit, dhe rekomandimeve që i ishin bërë z. Berisha i cili nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme, për të shmangur situatën me konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Më pas AKK i ka bërë zyrtarit të lartë edhe shkresën e dytë - paralajmëruese, me të cilën e ka njoftuar atë për situatën në të cilën ndodhet, për masat tjera që mund të pasojnë, nëse gjendja nuk ndryshon dhe njëkohësisht i jep afat të ri, por të kufizuar ligjor, për ta ndryshuar këtë gjendje, duke shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë zyrtari i lartë z. Berisha ka dërguar në Agjenci informatat zyrtare, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se në biznesin privat “VIP”, ka caktuar person të autorizuar për ta menaxhuar këtë biznes. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

